

Krijoni të ardhmën tuaj



Revista e klasës së parë – nr.1

Foto albumi i aktiviteteve




Viti shkollor
2015-2016,
Pejë

Së pari, na lejoni të prezantohemi!



Andi Kelmendi



Anil Ademaj



Klesti Ukëhaxhaj



Orgesa Gashi



Mësuese
Feriha Sallova



Era Gashi



Blinera Tahiraj




Ledion Berisha



Klesti Ukaj



Inara Bruçi



Dren Dinaj

Dita e parë
në shkollë
ishte
shumë e ëmbël...



...dhe kishte
shumë hapësira
për të eksploruar...



...ndërsa,
klasa jonë,
ishte
më e bukura!



Mësuam, dhe
filluam
të zbatojmë
rregullat
e klasës...



...ylli që
shkelqen
e priste
më të mirin
e javës...



...bankat
shkollore
u bënë pjesë
e jetës sonë!



Shumë
shpejtë
zbuluam
magjinë
e botës
së shkronjave



...dhe
të numrave...



...dhe
kënaqësinë
e lojës !





Mësuam
për
artin...



...këndimin...



...dhe
gjuhën
angleze !

...I lexuam
njeri tjetrit



...dhe
shpjeguam
cka është
më e madhe
dhe cka
më e vogel...



...dhe
kohën
si
ta masim!





...Dhe
një ngjarje
të tregojmë,...



...dhe dosjet
si rregullohen...



...dhe
këpucët
si ti lidhim!

Momente
të bukura
kaluam
në palestër!



Palestra
ishte vend
i lojës,...



...dhe i
dueleve!





Mësuam për
rëndesinë
e pemëve
dhe perimeve



...gatimin,...



...dhe
të mirat
e ushqimit
të
shendoshë!

Pas ushqimit
dhëmbët
duhet
pastruar
mirë,
thoshte
dentisti!



E mesuam
si lahen
dhëmbët
në mënyrë
të drejtë.



Ishte kontrolli
i parë
i dhëmbëve
pa frigë!





...Halloween



...dhurata
jonë e parë
për
Drejtorin
e Shkollës...



...Festuam
Ditën e
Flamurit
Kombëtar!

Pranuam
shumë dhurata
për festat
e fund-vitit.



Klasën
e dekoruam
vet.



Gëzuar
Vitin e Ri
2016! /





Flok-barin
që punuam...



...dhe
kartolinat
për
Ditën
e Mësuesit
dhe
Festën
e 8 Marsit...



...që të gjitha
i shitëm
në
ekspositën
shitëse!
Një projekt
tjetër kishim
në mendje!

Mbollëm
fidane
të
perimeve...



...dhe luleve...



...ishim
fermerë
të vyeshëm!





...ndërsa
për kujtim,
mbollëm
dhjetë fidane
trëndafili...



...dhe
një trung
bliri, ...



...që
kopshti ynë
të jetë
edhe
më i bukur!

Çdo gjë shkon mbarë kur fillon mirë!

Mikëpritja e kolektivit te shkolles "Cambridge", bashkëpunimi i prezervuar i prinderve që nga dita e parë e mësimit, zhvillimi i orëve mësimore me qeniet më të sinqerta dhe të dashura në botë e që janë nxënësit e klasës sime si dhe kushtet jashtezakonisht të mira të hapësirave përmësim, kanë qenë nxitje por edhe parakusht më se i mjaftueshëm për zhvillimin e procesit të mësimit dhe edukimit.

Përderisa zbatimi i planëprogramit mësimor nënkuptohet si synim parësor, synimi im i dytë i rëndësishëm gjatë përcjelljes së kësaj klase, do të jetë kuptimi i rëndësisë së të qenit pjesë e komunitetit duke mos e cenuar në asnjë mënyrë karakterin dhe individualitetin e nxënësit. Na mbetet të gjithëve një obligim i madh, që përmes bashkëpunimit në të ardhmen, të zbulojmë pasionin dhe ambicjen e çdo nxënësi, në mënyrë që të lehtësojmë rrugëtimin e tyre drejt cakut të vet jetësor!

Ju falenderoj që të gjithë, për besimin e dhënë dhe mundësinë të punoj me këta nxënës, ndërsa për ju prindër kam vetëm një porosi, lum Ju për fëmijët që keni!

Me respekt,
Mësueseja: Feriha Sallova



Mustafë Kadrijaj – Profesor i Edukatës Fizike

Eksperiencia më e veçantë e gjithë këtyre viteve si mësimdhënës i Edukatës Fizike ishte kjo e klasës së parë. Përveç kënaqësisë, ndiej edhe një çlodhje shpirtërore duke punuar me këta nxënës të zellshém. Mësimi i kësaj lënde ndikon në përmirësimin e forces, qëndrueshmërisë, fleksibilitetit dhe shpejtësisë. Kjo lëndë ka për qëllim që fëmijët të fitojnë dituri, shkathtësi dhe shprehi lëvizore.

Poashtu, të fitojnë shprehi pune të përbashkët, fitimin e njohurive higjenike dhe shprehive përmajtjen drejtë të trupit. Vlen të ceket që qëllimi kryesor i Edukatës Fizike është përvetësimi i lëvizjeve bazë natyrore dhe zbatimi i tyre gjatë jetës sipas kushteve natyrore si dhe përsosja e lëvizjeve bazë nga përbajtjet e gjimnastikës dhe atletikës.

Krenare Luta Radoniqi – Profesoreshë e Edukatës Figurative

Përvoja ime me nxënësit e klasës së parë ishte një kënaqësi e veçantë. Lënda e Edukatës figurative ka një rëndësi të veçantë si në zhvillimin edukativ ashtu edhe në arrtjet personale të nxënësve. Ajo u ofron nxënësve në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të qartë, njohuri elementare për ta nxitë prirjen e tyre nga fusha e artit figurative dhe në përgjithësi të arteve pamore.

Përbajtja e lëndës është e përshtatur në atë formë që pos mësimit të ofroj edhe kënaqësi përxënësit. Në rend të parë ajo synon të zgjojë interesim, të zgjojë imagjinatën krijuese dhe të kultivojë ndjenjën për kënaqësinë shpirtërore të së bukurës. Një gjë shumë e rëndësishme është që te fëmijët është zhvilluar dëshira për të mësuar duke kriuar.

Arta Krasniqi - Profesoreshë e Gjuhës Angleze

Përvoja ime me klasën e parë është e paharrueshme. Nxënësit ishin shumë të angazhuar gjatë aktiviteteve të ndryshme të zhvilluara në klasë. Synimi kryesor i kësaj lënde ishte njoftimi me gjérat themelore të kësaj gjuhe si dhe fitimi i shprehive fillestare për kulturën e të folurit dhe të shkruarit në Gjuhën Angleze.


Në Përgjithësi, nxënësit mësuan lidhur me shkronjat e alfabetit, pjesët kryesore të trupit, prezantimin e vvetves, numrat (1-10), emërtimin e pjesëtarëve të familjes, të njoftohen me gjérat që ndodhen në klasë, të dallojnë format dhe ngjyrat, të flasin përfestat e fundvitit, të mbajnë mend emrat e pemëve dhe perimeve, të dallojnë rrobat sipas stinëve të vitit. Nxënësit zhvilluan aftësitë bashkëpunuese dhe imagjinuese me anë të lojërave edukative, figurave dhe vizatimeve.

Ermira Efendia - Profesoreshë e Edukatës Muzikore

Pështypjet e mia për këtë klasë janë të veçanta. Kjo lëndë ka për synim që nxënësit të aftësohen përtë qenë selektiv dhe aktiv të muzikës në programet e mediave. Edukata Muzikore ka për qëllim të sjellë gëzim, emocione positive, të formoj qëndrim ndaj muzikës kombëtare dhe popullore si dhe të dalloj ngjyrat tingullore të instrumenteve, zërat e burrave, grave e fëmijëve në të kënduar.

Në këtë lëndë nxënësit mësuan të këndojnë këngë popullore dhe artistike të cilat ishin të përshtatshme nga përbajtja dhe karakteri shprehës përfshirë moshën e tyre. Poashtu ligjëruam ritmikisht vargjet e shkurtra të cilat i shoqëruam me lëvizje.






Mirëupafshim në Festën e Abetarës
Me 28 maj 2016



Krijoni të ardhmën tuaj



Tel: +377 (0)44 138 366; +377 (0)44 111 942

E-mail: schoolpeje@gmail.com

website: www.gjimnazicambridge.com

Address: Rr. Muharrem Mitrovica pn., Pejë